



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS  
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 611, Datë 10.04.2019

**“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 10.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

**Objekti:** Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar me vendimin nr. 597, datë 19.02.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 552, datë 04.10.2018.

**Baza Ligjore:** Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

**Komisioni i Konkurrencës**, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor,

**VËREN SE :**

1. Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, vendosi fillimin e procedurave hetimore në Shërbimin Spitalor i cili përfshin shërbimin publik dhe shërbimin privat.
2. Për realizimin e procedurave hetimore dhe vlerësimin e konkurrencës në treg (përcaktimin e strukturave të tregut, kryerjen e analizës së sjelljes, kryerjen e

analizave statistikore-ekonomike për të gjithë shërbimet shëndetësore), bazuar në nenet 33 dhe 34 të Ligjit nr. 9121/2003, janë kërkuar të dhëna dhe informacione në mënyrë shkresore nga: Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale, Spitalet Bashkiake, Spitalet Private si dhe institucionet; Ministrisë së Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale dhe Fondit të Sigurimeve të Detyrueshme të Kujdesit Shëndetësor.

3. Informacioni i depozituar deri tani është i paplotë dhe koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

#### **VENDOSI:**

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës 552, datë 04.10.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit të Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor, i ndryshuar, të ndryshohet si vijon:  
*“3. Raporti i Hetimit të Përgjithshëm duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 30 qershor 2019”.*
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I KONKURRENCËS**